

Pakoja e Ahtisaarit (Padrejtësitë themelore)

Paketa e Ahtisaarit është konkretizim, qartësim dhe saktësim i autonomise substanciale e cila parashihet sipas Rezolutës 1244. Paketa e Ahtisaarit ndodhet tërësisht brenda dy formulave të Serbisë: 'autonomi brenda autonomisë' për serbët dhe 'më shumë se autonomi, më pak se pavarësi' për Kosovën. Pra, gjithsesi më pak se pavarësi dhe madje larg saj, prandaj patjetër që autonomi. Dhe, për shkak të decentralizimit të Kosovës josovrane, Kosova si krahinë autonome në Serbi, do ta ketë përbrenda edhe autonominë e serbëve. Pjesët e pakos të cilat definitivisht e vërtetojnë këtë pohim janë:

Neni 1.2 – Kosovën e definon si shumësi të komuniteteve. Shqiptarët dhe serbët konsiderohen komunitete, edhe pse shqiptarët janë mbi 90% e serbët 6%. Pra, sipas pakos së Ahtisaarit, shqiptarët në Kosovë nuk janë as popull, e as komb.

Neni 1.3 – Njerëzit në Kosovë kjo pako i quan 'banorë' e jo qytetarë. Qytetari është burim i sovranitetit ndërsa 'banorë' është status që mund ta fitojnë edhe refugjatët. Ne po trajtohem si refugjatë në shtëpinë tonë!

Neni 1.6 – Gjuhë zyrtare në Kosovë është shqipja dhe serbishtja. Kjo është shumë më tepër sesa që kanë shqiptarët në Maqedoni e lëre më se shqiptarët në Luginën e Preshevës të cilët janë të shtypur dhe rëndë të diskriminuar.

Neni 1.8 – Nuk lejojnë as kërkesën për bashkim me ndonjë shtetë apo ndonjë pjesë të shtetit tjetër. Pra, kufizim drastik nga jashtë.

Neni 1.10 – Tregon se në Kosovë do të sundojë bashkësia ndërkombëtare, e jo populli e qeveria e saj. Po ashtu, në këtë nen parashihet që Kosova t'i bëjë ftesë bashkësisë ndërkombëtare për këtë!

Neni 1.6, Aneksi I - Dispozita Kushtetuese parasheh që të gjithë ata që kanë qenë qytetarë të ish Republikës Federative të Jugosllavisë dhe banorë të përhershëm të Kosovës deri më 1 janar 1998 si dhe pasardhësit e tyre kanë të drejtë për nënshtetësinë e Kosovës. Pra, QYTETARË të ish Republikës Federative të Jugosllavisë dhe BANORË të Kosovës! Kjo datë më së shumti iu konvenon serbëve kur dihet se mbi 300.000 shqiptarë ishin dëbuar nga Kosova gjatë të '90-tave, para 1 janarit të vitit 1998.

Neni 3.7, Aneksi I - Dispozita Kushtetuese e shpjegon qartë se si Kuvendi i Kosovës është i kurthuar nga e ashtuquajtura shumicë e dyfishtë: miratimi, ndryshimi apo shfuqizimi i ligjeve më të rëndësishme ka nevojë jo vetëm për shumicën e anëtarëve të pranishëm të Kuvendit por edhe shumicën e atyre nga komunitetet pakicë të cilët kanë edhe ulëse të rezervuara. Më tutje, në nenin 3.9 thuhet se asnjëri nga ato ligje të theksuara në nenin 3.7 nuk mund të jetë objekt i referendumit. Kjo është hera e vetme kur përmendet fjala referendum! Pra, atëherë kur ndalohet referendum!

Neni 10.1 Te amandamentet kushtetuese sërish te Aneksi I, thotë se çdo amandament në Kushtetutë mund të bëhet vetëm me 2/3 e deputetëve të Kuvendit përfshirë këtu 2/3 e atyre nga komunitetet pakicë të cilët kanë edhe ulëse të rezervuara!

Aneksi II - Të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në nenin 2.2 flet për mbështetjen e pajtimit ndërmjet komuniteteve! Nuk përmendet askund represioni dhe krimet e gjenocidi i forcave serbe si shkak, por për më keq, aludohet se problemi është inherent etnik gjë që e shfajëson Milosheviqin dhe Serbinë.

Neni 4, Aneksi III - Decentralizimi tregon qartë se si komunitetet e reja me shumicë serbe do të kenë kompetenca më të mëdha se sa komunitetet me shumicë shqiptare siç është rasti i arsimit sipëror (Universiteti në veri të Mitrovicës) dhe i shëndetësisë sekondare (licencimi dhe menaxhimi i spitaleve).

Neni 7.1.1, Aneksi III, e shpjegon se Ministria e Arsimit të Serbisë do t'i hartojë planprogramet për shkollat në gjuhën serbe në Kosovë. Në ato tekste shkollore të përpiluara prej Serbisë do të mësohet për luftën tonë çlirimtare si për një luftë terroriste! Një nen i tërë në po këtë Aneksin III, neni 10 me 6 pika i dedikohet bashkëpunimit me institucionet e Republikës së Serbisë.

Neni 12.4, Aneksi III, parasheh formimin e komunave të reja minoritare aty ku ata përbëjnë 75% dhe mbi 5.000 banorë! Andaj Serbia po i kthen serbët në mënyrë të përqendruar edhe për këtë arsye.

Aneksi V - Trashëgimia kulturore dhe fetare në nenin 1.2 thotë se Kosova do ta njeh Kishën Ortodokse Serbe të Kosovës, duke përfshirë manastiret, kishat dhe objektet tjera që shfrytëzohen për qëllime fetare, dhe si pjesë integrale e KOS-it me seli në Beograd. Ndërkaq, në nenin 6 thuhet se duhet të bëhet kthimi i artefakteve arkeologjike dhe etnologjike TË CILAT JANË MARRË HUA NGA MUZETË E KOSOVËS për ekspozim të përkohshëm në Beograd gjatë 1998-1999!

Aneksi VI - Prona dhe arkivi, në nenin 6.1, thuhet se Kosova duhet të adresojë me prioritet çështjet e kthimit të pronës së KOS-it.

Aneksi VIII - Sektori i sigurisë në Kosovë, në nenin 2.2 thotë se kufijtë e stacioneve policore rajonale do të jenë të njëjtë me kufijtë komunal. Kurse në pikën 2.2 thuhet se përbërja etnike e policisë brenda komunës deri në masë mundshme do të reflektojë përbërjenetnike të popullatës në komunë. Në po këtë Aneksin VIII pranohet uzurpimi i 2.500 hektarëve nga Maqedonia duke bërë referencën: Në deklaratën e tij të 7 marsit 2001, kryesuesi i Këshillit të Sigurimit, ndër të tjera përmendi: "Këshilli i Sigurimit bën thirrje për nevojën e respektimit të sovranitetit dhe integritetit territorial të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë. Në këtë kontekst thekson se marrëveshja demarkacionin e kufirit, e nënshkruar në Shkup më 23 shkurt 2001... duhet të respektohet nga të gjithë".

Aneksi VIII - Sektori i sigurisë në Kosovë, në nenin 5.2 thotë se FSK do të jetë e armatosur lehtë dhe nuk do të posedojë armë të rënda si, tanke, artileri të rëndë apo kapacitet ajror ofansiv. FSK do të përbëhet prej më tepër se 2500 pjesëtarë aktiv dhe 800 pjesëtarëve rezervë. Krahasojë këtë me ushtrinë serbe!

Aneksi VIII - Sektori i sigurisë në Kosovë, në nenin 6.1 thotë që TMK-ja do të shpërbëhet. Pikë.

Aneksi IX - Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, në nenin 4, shumë herë e përdor shprehjen 'Kosova do t'ia ofrojë PCN-së dhe PSBE-së...' Pra, kërkesën e tyre e shndërrojnë në ofertë të Kosovës! Kjo është ajo që thotë pakoja e dëmshme e Ahtisaarit.

- Paketa e Ahtisaarit nuk përmban vullnetin e shumicës së popullit të Kosovës dhe nuk i referohet askund atij. Pakoja e Ahtisaarit flet vetëm për të drejtat dhe privilegjet e pakicave, dhe atë vetëm të pakicës serbe. Pakoja e Ahtisaarit është pako proserbe. Kuvendi i ardhshëm i Kosovës do të jetë i varur nga formula e shumicës së dyfishtë: çdo vendim i Kuvendit ka nevojë për shumicën e përgjithshme dhe shumicën e pakicës gjë që praktikisht i jep të drejtë vetoje deputetëve serbë. Kuvendi i këtillë bile as që mund ta shpallë pavarësinë.
- Trashëgimi kulturore konsiderohet vetëm ajo fetare ortodokse e cila është definuar si 'serbe'. Pakoja do të parashohë themelimin e së paku 45 zonave të veçanta qindrahektarëshe.
- 3/4 e paketës së Ahtisaarit ka të bëjë me decentralizimin. Komunitetet e reja me shumicë serbe do të kenë kompetenca shumë më të mëdha sesa ato me shumicë shqiptare dhe plotësisht të pazakonshme për komunitet: p.sh. në arsim të lartë, shëndetësi dytësore etj. Lidhjet horizontale praktikisht dhe formalisht realizojnë entitetin autonom serb. Lidhjet direkte vertikale me Beogradin, dhe financimin e tij i cili do të jetë i liruar nga taksat në Kosovë, bëjnë që ky entitet të jetë vetë Serbia. Ai do të ngërthejë afër 1/3 e territorit të Kosovës. Do t'i ketë dy qendra: Mitrovicën për veriun dhe Graçanicën për pjesën qendrore e lindore të Kosovës.
- Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar i cili njëkohësisht do të jetë edhe Përfaqësues Special i BE-së do ta ketë fjalën përfundimtare. Ky monark i ri do të ketë fuqi korrektuese (ndryshim të ligjeve) dhe zëvendësuese (përfundim të ministrave e zyrtarëve tjerë dhe emërim të dikujt tjetër në ato poste). Misioni i ardhshëm ndërkombëtar do të ketë një zyre në Mitrovicë përgjegjëse jo vetëm për veriun e Mitrovicës por edhe për komunitetet e Leposaviqit, Zveçanit e Zubin Potokut. Dhe, do ta ketë një zyre në Beograd (jo edhe në Tiranë!) funksionimi dhe kompetencat e së cilës do të varen edhe nga qëndrimi i Qeverisë së Serbisë.
- Në vend që të flitet për dëmet e luftës që Serbia ia ka shkaktuar Kosovës, ky mision do të merret me borxhet e Kosovës. Pra, do t'i shfrytëzojnë e shtrydhin pasuritë dhe burimet e Kosovës edhe në emër të borxhit. Përfaqësimi i Kosovës jashtë do të jetë vetëm në borxhin e jashtëm!
- Më 1999 në vend se të çarmatosej ushtria kriminale serbo-jugosllave u çarmatos UÇK-ja. Tash, në vend se të shpërbëhen strukturat paralele policore dhe paramilitare të Serbisë në Kosovë, pakoja e Ahtisaarit parashihet shpërbërjen e TMK-së fillimisht nëpërmjet zvogëlimit të numrit të zonave nga gjashtë në tri sosh.

E, Lëvizja VETËVENDOSJE! thotë luftoje pakon me çdo kusht. Ndale copëtimin e Kosovës!